



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**  
***Nënkomisioni për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe***  
***Këshillit të Lartë të Prokurorisë***

Tiranë, më 17 Shtator 2024

Dokument Parlamentar

**RAPORT**

**Mbi përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë**

**Hyrje**

Bazuar në pikën 9 të nenit 35, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit në datën 20.06.2024, i ka përcjellë Komisionit për Çështjet Ligjore në Kuvend, raportin e vlerësimit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet kushtetuese dhe ligjore, listën e kandidatëve të përjashtuar, së bashku me dokumentacionin për kandidatët për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë nga përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Pranë Komisionit për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, janë depozituar paraprakisht raportet e vlerësimit, listat dhe dokumentacioni i kandidatëve, përkatësisht për:

1. Kandidatët për KLGJ nga përfaqësuesit e shoqërisë civile;
2. Kandidatët për KLP nga përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Në zbatim të nenit 35, pika 11, të ligjit nr. 115/2016, Komisioni për Çështjet Ligjore në Kuvend, jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e listës nga Sekretari i Përgjithshëm, duhet të krijojë një nënkomision me 5 deputetë, prej të cilëve 3 caktohen nga radhët e shumicës parlamentare dhe 2 nga radhët e pakicës parlamentare, për vlerësimin e mëtejshëm dhe përzgjedhjen e kandidatëve.

Në mbledhjen e datës 01.07.2024, Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut u njoh me njoftimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit për përfundimin prej tij të procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidatëve.

Në vijim Komisioni në zbatim të pikës 19 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016 shqyrtoi projekt-rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e nënkomisionit për përzgjedhjen e kandidatëve

për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar”. Komisioni vendosi miratimin e kësaj projekt-rregullore me vendimin nr. 6 datë 01.07.2024. Kryetarja e Komisionit bazuar në pikën 11 të nenit 35 të ligjit 115/2016, informoi të gjithë anëtarët e komisionit lidhur me kërkesën drejtuar grupeve parlamentare për caktimin e përfaqësuesve të tyre në nënkomisionin e përzgjedhjes së kandidatëve.

Nga përgjigjet e administruara nga grupet parlamentare, komisioni me unanimitet, me vendimin nr. 7, datë 01.07.2024, vendosi krijimin e nënkomisionit të përzgjedhjes së kandidatëve nga përfaqësuesit e shoqërisë civile me këtë përbërje:

1. Znj. Klotilda Bushka, Kryetare (përfaqësuese e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste),
2. Znj. Dhurata Çupi, Nënkyetare (përfaqësuese e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike),
3. Z. Damian Gjikhuri, Anëtar (përfaqësues i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste),
4. Z. Gazment Bardhi, Anëtar (përfaqësues i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike),
5. Z. Klevis Xhoxhi, Anëtar (përfaqësues i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste).

### **Veprimtaria e Nënkomisionit**

Në përputhje me parashikimet e pikës 12 të nenit 35 të ligjit nr. 115/ 2016 dhe të nenit 4 të Rregullores së Nënkomisionit “Për organizimin dhe funksionimin e nënkomisionit për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar” mbledhja e parë e nënkomisionit me pesë anëtarë u njoftua nga Kryetarja për në datën 01.07.2024 dhe u zhvillua në datë 02.07.2024.

Në zbatim të parashikimeve të nenit 4 pika 1 të rregullores, Kryetarja e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut i ka përcjell menjëherë secilit prej anëtarëve të nënkomisionit raportet e vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm, listat e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore, listat e kandidatëve të përjashtuar, dokumentacionin për secilin kandidat, për të dy Këshillat.

Në rendin e ditës të mbledhjes së parë ishte konstituimi i Nënkomisionit si dhe shqyrtimi dhe miratimi i kalendarit të punimeve të nënkomisionit.

Në mbledhjen e datës 02.07.2024, ishin të pranishëm katër anëtarë të nënkomisionit. Pas miratimit të kalendarit të punimeve të tij, mbledhja e nënkomisionit vijoi me konstitutimin e nënkomisionit dhe miratimin e kalendarit të punimeve të tij.

Nënkomisioni u mbledh në mbledhjen e radhës me datë 03.07.2024 ku prezent ishin katër anëtar të nënkomisionit. Në këtë mbledhje u vijua me dëgjuesën e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, i cili prezantoi para nënkomisionit punën e zhvilluar në përputhje me pikën 5 të neneve 147 dhe 149 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikave 2-10 të nenit 35 të

ligjit nr. 115/2026.. Në përfundim të prezantimit të raportit nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit anëtarët prezent në mbledhje u dakordësua që mbledhja të ndërpritet me qëllim vënien në dispozicion të një kohe më të gjatë për njohjen me dokumentacionin e procedurës meqenëse ky dokumentacion është voluminoz.

Dëgjesa me Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit vijoi më datë 16.07.2024 ku deputetët e pranishëm bënë komentet e tyre në lidhje me raportin e vlerësimit të kandidatëve nga Sekretari i Përgjithshëm.

Përfaqësuesi i opozitës z. Gazment Bardhi vijoi me një analizë për kandidatët që janë pjesë e listës së kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret kushtetuese dhe ligjore sipas Sekretarit të Përgjithshëm dhe konkludoi në arsyetimin se kandidatët që janë pjesë e listës së lartpërmendur janë përjashtuar në shkelje të ligjit dhe në tejkalim të kompetencave nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, në tejkalim të kriterëve dhe kushteve ligjore të parashikuara nga kushtetuta dhe ligji, vlerësim ky i cili i ngushton mundësinë nënkomisionit për të përzgjedhur anëtarët e Këshillave dhe bën të pamundur edhe aplikimin e procedurës kushtetuese të shortit, për faktin që është në garë vetëm nga një kandidat për secilin nga të dy këshillat, duke humbur konceptin e përzgjedhjes rastësore në mungesë të 4 votave për secilin nga kandidatët.

Z. Bardhi theksoi se vlerësimi i kryer nga Sekretari i Përgjithshëm ka mbajtur standarde të dyfishta për kandidat që gjenden në të njëjta kushte sikundër në raportin e dorëzuar ka vlerësime që tejkalojnë kompetencat e tij.

Kryetarja e Nënkomisionit vijoi duke thënë se bazuar në materialet e përcjella nga Sekretari i Përgjithshëm rezultoi që procesi është i normuar në Kushtetutë dhe në ligj si dhe analizat e kryera dhe vlerësimet e bëra janë në përputhje me kriteret strikte, ashtu siç parashikojnë drejtpërdrejt normat, pasi Sekretari i Përgjithshëm ka autoritetin për të bërë vlerësimet e veta kushtetuese.

## **Procesi i votimit**

Në datë 26.07.2024 nënkomisioni u mbledh në mbledhjen e radhës. Kryetarja e nënkomisionit sqaroi se referuar rendit të ditës do të zhvillohej votimi i kandidatëve për të dy Këshillat. Gjithashtu referuar pikës 15 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016 nënkomisioni do të vijojë me votimin e listës së kandidatëve të skualifikuara dhe nëse nga kjo listë nëpërmjet votës mund të kualifikohet ndonjë kandidat.

**Kryetarja e nënkomisionit hodhi në votim emër për emër kandidatët e pakualifikuar në listën e përcjellë nga Sekretari i Përgjithshëm për të dyja Këshillat sipas përcaktimeve të nenit 35, pika 7, germa “b” të ligjit nr. 115/2016.**

Votimi i listës së kandidatëve të pakualifikuar të përcjellë nga Sekretari i Përgjithshëm, u shoqërua me diskutimin e anëtarëve të nënkomisionit, të cilët paraqitën qëndrimet e tyre, duke u mbështetur në dokumentacionin e ndodhur në dosjet individuale, si dhe në raportin e vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit.

Asnjë nga kandidatët nga kjo listë, nuk mori votat e mjaftueshme sipas përcaktimeve të nenit 35, pika 13 të ligjit nr .115/2016, për t'u përfshirë në listën e kandidatëve që i plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji 115/2016.

Nënkomisioni në datën 17.09.2024, zhvilloi procesin e dëgjësës së kandidatëve të kualifikuar, të cilët u dëgjuan sipas rendit alfabetik dhe ju drejtuan pyetje nga anëtarët e nënkomisionit.

**Më pas, kryetarja e nënkomisionit hodhi në votim për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, emër për emër, sipas rendit alfabetik të emrit, listën e përcjellë nga Sekretari i Përgjithshëm me kandidatët që i plotësojnë kushtet, në përputhje me nenin 35, pika 7 shkronja “a”, e ligjit 115/2016.**

Në përfundim të procedurës së votimit rezultoi se asnjë kandidat për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk mori minimumin prej 4 votash të nevojshme për t'u konsideruar kandidat i miratuar nga nënkomisioni në përputhje me pikën 14 të nenit 35 të ligjit.

**Më pas, kryetarja e nënkomisionit hodhi në votim për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, emër për emër, sipas rendit alfabetik të emrit, listën e përcjellë nga Sekretari i Përgjithshëm me kandidatët që i plotësojnë kushtet, në përputhje me nenin 35, pika 7, shkronja “a”, e ligjit 115/2016.**

Në përfundim të procedurës së votimit rezultoi se asnjë kandidat për anëtar të Këshillit të Lartë Prokurorisë, nuk mori minimumin prej 4 votash të nevojshme për t'u konsideruar kandidat i miratuar nga nënkomisioni në përputhje me pikën 14 të nenit 35 të ligjit.

Në kushtet kur nga procedura e votimit nuk rezultoi asnjë kandidat me numrin e nevojshëm të votave sipas përcaktimeve të nenit 35, pika 14 të ligjit 115/2016, kryetarja e nënkomisionit ftoi sekretariatit teknik të përgatisë procedurën e shortit për përzgjedhjen e kandidatëve fillimisht për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe më pas për Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Në përputhje me përcaktimet e rregullores, shorti manual u zhvillua sipas kësaj procedure:

- emri i çdo kandidati nga lista përkatëse, i cili merr pjesë në short, i shënuar në shirita letre, u lexua me zë të lartë, iu tregua të pranishmëve dhe më pas u mbyll në gogla të njëjta nga ngjyra dhe forma e jashtme dhe hidhet në enën transparente;
- sekretaria teknike e nënkomisionit tërhoqi njëërën nga goglat e hedhura në enën transparente, të cilën e hapi, e lexoi me zë të lartë, duke treguar emrin e kandidatit të përzgjedhur nga shorti.

Shorti u hodh sipas përcaktimeve të nenit 5, pika 8 të Rregullores së Nënkomisionit ku kandidati i përzgjedhur me votim plotëson vendin bosh që krijohet nga përfundimi i mandatit

të anëtarit që është përzgjedhur i pari me short ose me votim në procesin e mëparshëm të përzgjedhjes së kandidatëve për Këshillin.

Në përfundim të procedurës së shortit për anëtarët nga përfaqësuesit e shoqërisë civile për Këshillin e Lartë Gjyqësor, rezultoi fitues kandidati i mëposhtëm:

1. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor Naureda Llagami zëvendësohet nga Erion Fejzulla;

Duke qenë se z. Fejzulla ishte kandidati i vetëm i kualifikuar për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nënkomisioni nuk vijoi me procedurën e shortit për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Rezultatet e votimit dhe shortit gjenden bashkëlidhur, si pjesë e këtij raporti.

Pas përfundimit të procesit të votimit dhe të shortit, nënkomisioni miratoi listën përfundimtare me emrin e 1 kandidati nga përfaqësuesit e shoqërisë civile për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe vendosi përcjelljen e listës Kryetarit të Kuvendit, në përputhje me parashikimet e pikës 15 të nenit 35 të ligjit 115/2016 dhe nenit 5 pika 8 të Rregullores së Nënkomisionit.

**KLOTILDA BUSHKA**

**KRYETARE E NËNKOMISIONIT**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut  
Nënkomisioni për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe  
Këshillit të Lartë të Prokurorisë*

**REZULTATI I SHORTIT**

<b>Nr.</b>	<b>Kandidatët e përzgjedhur nga nënkomisioni për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga përfaqësuesit e shoqërisë civile</b>
<b>1</b>	<b>Erion Fejzulla</b>